



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/02-17794
Dt. 04.09.2020

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë

VENDIM (për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	N.T.SH.T.P."GOGAJ AG" nga Deçani.		
Rruga:	Deçan		
Telefoni:	044 455 447	Emaili:	

Emri i Projektit:	Objekt i kategorisë së parë me destinim - auto larje (gjysëm e hapur) , me etazhitet P+0		
Emri i Projektuesit:	Ndërmarrja projektuese ndërtimore "2B Design" SH.P.K		
Adresa:	Rruga " Tirana " pn. - Prizren		
Telefoni:	044 //////////////	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:			
Adresa: Rruga "Gjergj Sokoli" pn.			
Zona(t) Kadastrale: Gjakovë – J - Qytet	Nr. i parcelave kadastrale: 4344-5 dhe 4344-6	GPS Koordinatat:	

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Ndërtim i ri	<input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim	<input type="checkbox"/>
Riparim	<input type="checkbox"/>		
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria I	<input checked="" type="checkbox"/>	Kategoria II	<input type="checkbox"/>
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>		
Përshkrimi: Lejohet ndërtimi i objektit të kategorisë së parë me destinim – auto larje (gjysëm e hapur) , me etazhitet P+0.			

Me këtë vendim, poseduesi i lejes ndërtimore: **N.T.SH.T.P."GOGAJ AG" nga Deçani**, i lejohe ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim auto larje (gjysëm e hapur) , me etazhitet P+0, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit për ndërtim **S=99.00m²**.

Përdhesa:

(Sip,Bruto): S= 99.00 m²

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelen informuese në vend ndërtim me informatat e më poshtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollin e miratuar të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.



Ar sy e t i m

Salih Gashi nga Fushë Kosova në cilësinë e Qiramarrësit, bazuar në Aktin Noterial – Kontratë për Qiranë me nr. LRP.nr.1542 të datës 29.05.2020 nga qiradhënësi N.T.SH.T.P."GOGAJ AG" nga Deçani, përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-17794, të datës 18.08.2020, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim auto larje (gjysëm e hapur) me etazhitet P+0, në ngastrat kadastrale me numër 4344-5 dhe 4344-6, ZK: Gjakovë-J-Qytet, në pronësi të N.T.SH.T.P."GOGAJ AG".

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 24.06.2020, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
- Kopjen e planit të datës 28.05.2020 (fotokopje) së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës 493/20, të datës 07.02.2020, në pronësi të N.T.SH.T.P."GOGAJ AG" nga Gjakova të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Vërtetimi mbi tatimin ne prone nr. 430-L-1758 të datës 29.05.2020.
- Vendimi për Kushtet Ndërtimore me nr. 07/351-01-7484 të datës 24.06.2020.
- Aktin Noterial – Kontratë mbi Qiranë LRP.nr. 1542/2020, dt. 29.05.2020.
- Çertifikata nga Drejtoria për punë inspektuese – Inspektorati Sanitar me nr. 14-530/01-14543 të datës 13.06.2020.
- Lejen mjedisore komunale me nr. 07/350/01-15429 të datës 02.09.2020.
- Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr. 4/473, dt. 13.07.2020.
- Pëlqimin nga K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Gjakovë, nr. 1150 të datës 06.07.2020.
- Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, të datës 07.07.2020.
- Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në IFJB Capital filiali në Gjakovë me datë 01.09.2020.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga Ndërmarrja projektuese "2B Design" SH.P.K – Prizren.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej : 254.43 Euro

Shtojcë: Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: Plani i Situacionit së bashku me kushte lokacioni, me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, në përpjesë 1:500 të datës 24.06.2020 të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- Investitorit, Drejtorisë për Punë Inspektuese, Arkivit.

Zyrtar i lartë për çështje juridike

ST
Zenel Shabani, jur. i dipl.



K.K. GJAKOVË

Zona. kadastrale : Gj.j.Qytet

Parc. nr.4344-5,4344-6

PLAN SITUACIONI

